

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-** Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Ramiz Azizi me sekretaren juridike Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit S. R.nga Gj, për shkak të kryerjes së 17 veprave penale vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 (16 sosh) një nga neni 253 paragrafi 1 nën.1.1 dhe 1 nga neni 252 par.1 të KPK-së, të cilin me autorizim e përfaqëson mbrojtësi av.... nga Gj, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti I Përgjithshëm dhe atë PP.II.nr.709/2013 e datës 05.07.2013, PP.II.nr.887/13 të datës :13.05.2013,PP.II.nr.21/15 e datës:13.01.2015. PP.II.nr.719/13 të datës; 2504.2013, PP.II.nr.955/13 e datës : 13.06.2013, PP.II.nr.905/15 e datës 17.05.2013, PP.II.nr.775/13 e datës :02.05.2013, PP.nr.1327/13 e datës :31.07.2013, PP.II.nr. 45/14 e datës: 17.01.2014, PP.nr.1213/12 e datës 09.07.2012 dhe PP.II.nr.177/13 e datës :11.02.2013. Të cilat I përfaqësonte prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së seancës gjyqore Kryesore, verbale dhe publike me datën 17.12.2015 me datë: 18.12.2015 mori dhe shpalli këtë :

## **A K T G J Y K I M**

I akuzuari S.R. nga babai B. dhe nëna R, e lindur B, i lindur me datë:, në Gjilan rruga “..i pa martuar , i pa punë, e ka të kryer shkollën fillore i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar Shtetas I Republikës së Kosovës, gjendet në vuajtje të dënimeve, për vepra të ngjashme penale.

## **Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse**

**I**

### **Të pandehurit S.dhe Sh.**

Më datë : 29-30.01.2013, në intervalin kohor prej 16-08:00, në Gj, në dyqanin e paisjeve të makinerisë, N.T.”AD”, në rrugën Qarkore përkatësisht te restoranti “..”, me qëllim të pasurimit të kundërligjshëm, me forc e kishin hapur me anë të një kaçavide dritaren e plastikës dhe i pandehuri S kishte depërtuar mbrenda, ndërsa i pandehuri Sh. kishte qëndruar jashtë, me që rast i pandehuri S , përmes dritares ia kishte dhënë 8 (tetë) fellne të pandehurit Sh.. , i kishin dërguar afër rrugës kryesore kishin ndaluar një taksi, dhe të njëjtat i kishin dërguar në fshatin B, dhe ia kishin shitur të pandehurit H. A, dhe në këtë mënyrë të dëmtuarit R. Ai nga fshati P , i kanë shkaktuar dëm në vler të pa caktuar.

*-me qka në bashkryerje si bashkëegzekutor kanë kryer veprën penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.*

## **II**

### ***Të pandehurit S dhe Shkëndrim Rashit-nr...***

*Në muajin shkurt të vitit 2013, rreth orës 22.30 h , në garazhin-servisin e automjeteve lokalit D.P.Z “...” në rrugën qarkore afër restorant ..në Gj. me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm pasuror me marrjen e sendeve të huaja të luajtshme , kanë kryer vjedhje të rëndë , në dëm të dëmtuarit Sh. S. në atë mënyrë që me anë të forcës kanë hapur derën e garuzhdës dhe pasi që kanë hyrë mbrenda kan marr disa pjes të veturave nga materjali i aluminit si dhe dy kablllo të rrymës elektrike të gjatësis 30 metra dhe 40 metra duke i shkaktuar të dëmtuarit dëm materja në vlerën rreth 300 E.*

*-me qka në bashkryerje kanë kryer vepër penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.*

## **III**

*Në muajin mars të vitit 2013 rreth orës 11.00 h , në rrugën “...” në lokalit SHPK “..në Gj. me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm pasuror me marrjen e sendeve të huaja të luajtshme, ka kryer vjedhje të rëndë , në dëm të dëmtuarit M. M, në atë mënyr që me anë të forcës ka hapur derën e loaklit, ka hyrë mbrenda dhe pasi që nuk ka gjetur sende me vlerë është larguar nga lokali pa marr azgjë duke i shkaktuar dëm të dëmtuarit dëm materjal në vler të pa përcaktuar.*

*- me qka ka kryer vepër penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 28 paragrafi 1 dhe 2 të KPRK-së.*

## **IV**

*Mes datës:12/13.04.2013, rretjh orës 17:00-17-30 h , në rrugën “... “ numër në Gj , me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror me marrjen e sendeve të huaja të luajtshme, ka kryer vjedhje të rëndë , në dëm të dëmtuarit N. Z.në atë mënyr*

*që me anë të forcës ka hapur dritaren e podrumit të shtëpis së dëmtuarit, ka hyrë mbrenda dhe pasi që nuk ka gjetur sende me vlerë është larguar nga lokali pa marr azgjë duke i shkaktuar të dëmtuarit dëm materjal në vlerën e pa përcaktuar.*

*- me qka ka kryer vepër penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 28 paragrafi 1 dhe 2 të KPRK-së.*

## V

*Mes datës .26/29.03.2013, në kohë të papërcaktuar në Gj., në rrugën “....” afër shkollës së re në lagjen e tetë, me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm pasuror me marrjen e sendeve të huaja të luajtshme, ka kryer vjedhje të rëndë në dëm të dëmtuarit M. A., në atë mënyr që me anë të forcës ka hapur derën e ballkonit dhe ka marr një bateri-akumulator 55 amper, para të gatshme 10 euro si dhe një orë xhepi, duke i shkaktuar të dëmtuarit dëm materjal në vlerën e papërcaktuar.*

*- me qka ka kryer vepër penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 , lidhur me neni 28 paragrafin 1 dhe 2 të KPRK-së.*

## VI

*Me datë :24.08.2013, reth orës 22.00 h , Gjilan rruga “.. “, më saktësisht në lokalin “...”, i pandehuri më qëllim që vetit ti sjedh përfitim të kundërligjshëm pasuror , ka kryer vjedhje të rëndë në dëm të dëmtuarit Sh. D. , në atë mënyr që me përdorimin e forcës dhe mjetit të përshtatshëm më një kaqavid e hap llamarinë e aluminit të pjesës së poshtme të derës së hyrjes dhe nëpërmjet saj depërton në brendi , ku nga aty vjedh 37 euro , duke i shkaktu të dëmtuarit dëm në vler të pa përcaktuar.*

*-me qka ka kryer vepër penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së.*

## VII

*Më datë 21.02.2013, pas mesnate , në Gj në rrugën ‘...’, përkatësisht përball Spitalit Regjional te ndërtesat e bardha , me qëllim të pasurimit të kundërligjshëm, me forcë kishte hapur një dritare përmbi derën e shitores ushqimore ‘...’ dhe kishte depërtuar brenda, me qrast ka vjedhur 5 (pesë) boksa cigare të llojit ‘..’ dhe një kontë kavanoz djathë, dhe është larguar pa e vërejtur askush dhe ën këtë mënyrë të dëmtuarit V. A. ka shkaktuar dëm në vler të papërcaktuar.*

*- me qka ka kryer vepër penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së.*

### **VIII**

*Me datë 27-28.03.2013 , më intervalin kohor prej 22:00-08:00, në rrugën ‘...’ në Gj me qëllim të pasurimit të kundërligjshëm , me forc ka hapur dritaren e banjossë shtëpis së S.S. dhe ka marr një jakne meshkujsh, dhe të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm në vler të pa përcaktuar.*

*-me qka ka kryer vepër penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së.*

### **IX**

*Më datën 05-10.04.2013 në intervalin kohor prej orës 23:00:30, në rrugën ‘Afrim Gagica’ me qëllim të pasurimit të kundërligjshëm me forcë ka hapur derën e dyqanit dhe kishte depërtuar mbrenda, i kishte marrë disa gypa të bakrit të cilët i kishte shitur në grumbullimin e mbeturinave ‘..’ në rrugën e ....dhe të dëmtuarit F.O. i kishte shkaktuar dëm në vler të pa përcaktuar.*

*-me qka ka kryer vepër penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së.*

### **X**

#### **Të pandehurit S.dhe Sh**

*Në mes datës 06-07.02.2013, në intervalin kohor prej orës 17:00-08:00, në Gjilan, në rrugën Qarkore afër restorant ‘,...’, me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm pasuror për vete, nga shitorja e paisjeve të makinerisë në N.T.,AD,, e të dëmtuarit D. A nga fshati Zh ,K,Gj., kanë marr 10 fellne të veturave në vler të përgjithshme prej 350 –EURO, në atë mënyr që me forc hapin dritaren e shitores në fjalë,*

*depërtojnë mbrenda dhe nga i njëjti marrin sendet e lartpërmendura e largohen në drejtim të panjohur dhe kështu të dëmtuarin e dëmtojnë për ato fellne.*

*-me qka në bashkryerje kanë kryer veprë penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.*

## **XI**

*Me datën 11.04.2013, rreth orës 23.30 minuta , në Gj, mnë rrugën “...” afër ambulancës ku shitet zalli, me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm pasuror për vete, nga kasa e lokalit-shitorës ushqimore ....të dëmtuarit Q. K.nga Gj ka marr 4 euro në atë mënyr që me kaqavidë e ka këputur drynin e derës së shitorës së lartpërmendur, ka hyrë mbrenda, i ka marr parat në fjalë dhe është larguar nga aty dhe kështu të dëmtuarin e ka dëmtuar për parat e lartpërmendura dhe vlerën e pa përcaktuar të dëmit në dry dhe në dert ë lokalit në fjalë.*

*-me qka ka kryer veprë penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi .1 të KPRK-së.*

## **XII**

*Me datën 06.04.2013, rreth orës 14.26 minuta , në Gj në rrugën e vjetër të ‘..’ mbrapa restorant’ ...’ me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm pasuror për vete, në një shtëpi të një të dëmtuari i cili gjendet në botën e jashtme për të cilin e siguron kompanija e sigurimit “...” ka tentuar me forcë me depërtuar në brendësi të saj dhe nga e njëjta të merr gjësende të ndryshme me vler, mirpo aktivizohet alarmi dhe i pandehuri ik nga vendi i ngjarjes dhe kështu mbetet pa e përfunduar veprën penale të vjedhjes së rëndë të cilën më pas në polici e raporton punëtori i këtij sigurimi S. B nga Gj*

*-me qka ka kryer veprë penale vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.*

## **XIII**

*Naten në mes të datës 21-22.05.2013 , në intervalin kohor prej orës 18.00 -08.00 minuta në Gj, në rrugën “...” në ndërtesën e restorant ,, ..,, me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm pasuror për vete, nga lokali i të dëmtuarit ,,.. , nga Gj ka marr kasën e parave dhe parat 20 euro të cilat ishin në atë kasë, ën atë mënyr që me kaqavid e ka hapur derën e podrumit të këtij lokali ka hyrë mbrenda dhe nga i njëjti ka marr kasën në fjalë bashk me parat në vler prej 20 euro të cilat ndodhëshin në atë kas, dhe ka shkuar me një livadh atyh e ka hapur kasafortën dhe nga e njëjta i ka marr 20 euro e përmendura dhe në këtë mënyr të dëmtuarin e ka dëmtuar për dëmin në der , vlerene kasafortës dhe shumën prej 20 eurove.*

*-me qka ka kryer vepër penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1. të KPRK-së.*

#### **XIV**

*Në muajin mars të vitit 2013, rreth orës 00:00 minuta , në Gj. , në rrugën e fshatit M., me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm pasuror për vete , në kafiteri “..” të dëmtuarit B. M.i ka marr një protofol në të cilin kishin qen 30 euro para të metalta , në taë mënyr që me forcë hap derën e lokalit , depërton mbrenda dhe nga i njëjti i mer portofolin e lartëpërmendur, e më pastaj largohet në drejtim të panjohur dhe në këtë mënyr të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm matejal në vlerën e lartëpërmendur.*

*-me qka ka kryer vepër penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1. të KPRK-së.*

#### **XV**

*Me datën 21.09.2013, ne intervalin prej orës 21:00-22:20 minuta,, ne Gj në rrugën “..” me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm për vete, duke e përdorur forcën ka dëpërtuar në shitoren...” të dëmtuarës M. V.nga Gj dhe nga e njëjta merr 160 euro nga kasa ; 12. Kanaqe Red-Bull”10 kanaqe Red –Rain, 10 kanaqe Red –Eagle , dhe 20 pako cigare të llijit”Mallboro” në atë mënyr që me forcë e ka hapur derën e kësaj shitorje përmes saj depërton mbrenda dhe nga e njëjta i ka marr parat , pijet dhe cigaret e lartëpërmendura dhe është largur në drejtim të panjohur dhe në këtë mënyr për ato para, pije dhe cigare e ka dëmtuar të dëmtuarën.*

*-me qka ka kryer vepër penale vjedhje rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së.*

## **XVI**

*Më datën 13.04.2012 rreth orës 00:00 , në Gjilan, në rrugën e F, saktësisht në objektin e vjetër të supermarketit “..” i pandehuri me qëllim që vetes ti sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror në dëm të dëmtuarit R. S , ka kryer vjedhje të rëndë, në atë mënyr q ë me përdorimin e forcës ka hapur derëne hyrjes së lookalit dhe ka depërtuar brenda dhe në aktin e dytë nga sirtari i tavolinës së kompjuterit ka marr para të gatshme 50 euro dhe në këtë mënyr të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm materjal në vler të papërcaktuar.*

*-me qka ka kryer vepër penale vjedhje rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënparagrafi 1. të KPK-së.*

## **XVII**

*Më datën 12.06.2012 në intervalin kohor prej orës 19;00 deri 22:00, në Gjilan rruga “...” numër..., i pandehuri më qëllim që vetes ti sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror në dëm të dëmtuarit R.V, ka tentuar të kryej vjedhje , ashtu që përmes një dritare të ballkonit të shtëpisë ka hyr mbrenda ne dhomën e fjetjes se të dëmtuarit dhe më qëllim vjedhje ka kontrolluar nepër fjoka por nuk ka gjetur azgjë dhe në këtë mënyr të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm materjal ne vlërë të papërcaktuar.*

*-me qka ka kryer vepër penale tentim vjedhje nga neni 252 paragrafi 2 të KPK-së.*

*Andaj Gjykata në bazë të neneve 3,6,11,15,23,34,38 dhe 39 të KPK-së, si dhe të neneve 4,7,17,21,45,46,73,74,75,76,80 dhe 114 të KPRK-së, si dhe të neneve 365,451 dhe 463 të KPPRK-së, atë:*

## **E GJYKON**

*Të akuzuarin S. R:*

*Për veprën penale nënë disozitivin I të këtoij aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 ( gjashtë ) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin II të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë ) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin III të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë ) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin IV të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë ) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin V të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë ) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin VI të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë ) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin VII të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë ) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin VIII të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë ) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin IX të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë ) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin X të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë ) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin XI të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 5(pesë ) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*



*Për veprën penale nënë disozitivin XII të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 5(pesë) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin XIII të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 5(pesë) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin XIV të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 5(pesë) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin XV të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve dhe dënim me gjob në shumë prej 100 (njëqind) euro*

*Për veprën penale nënë disozitivin XVI të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër ) muajve.*

*Për veprën penale nënë disozitivin XVII të këtojt aktgjykimi në dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër ) muajve , gjithsej dënim me burgim në kohëzgjatje prej 93(nodhjet e trë) muajve që i bie 7(shtatë) vite e 9(nëntë) muaj, dhe 1500( njëmi e pesëqind ) euro dënim me gjobë.*

***E konform nenit 80 paragrafi 2 pika 2.3 të KPPRK-së, të njëjtit i shqiptohet dënimi me unik me burgim në kohëzgjatje prej 7(shtatë) viteve e 6 (gjashtë) muajve , si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind ) eurove të cilat i njëjti do ti vuaj pas plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi gjegjësisht në përiudhën prej 3(tre) muajve do ti paguaj gjobën e lartëcekur e nëse nuk mundet apo nuk dëshiron që ta paguaja tij e njëjta i zëvendëzohet me dënim burgimi ku 20(njëzet ) euro do ti llogariten baraze me një ditë burgimi.***

*Palët e dëmtuara në këto vepra penale ; për realizimin e kërkeses pasurore juridike udhëzohen në kontestin civil.*

*Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 eurove , si dhe hargjimet e procedurës penale në shumën e përllogaritur sipas llogaris përfundimtare të kësaj gjykate , e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmërija e këtij aktgjykimi.*

## **XVIII**

**Konform nenit 364 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPPRK-së, dhe ne mungese te provave , i akuzuari S.t R.**

### **LIROHET NGA AKUZA SEPSE**

*Më datë 08.12.2012, në intervalin kohor 18:30-31:20, në lokalin ‘..’ në rr.”..’ në Gj, me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm pasuror me marrjen e sendeve të huaja të luajtshme, ka kryer vjedhje të rëndë, në dëm të dëmtuarit R.M., në atë mënyr që me forcë ka hapur derën e hyrjes së shitores, pasi që ka hyrë mbrenda ka marr 150 (njëqind e pesdhjet) euro të metalta, 50 Franga Zvicrane të metalta, një palë patika dhe një palë këpucë, duke i shkaktuar dëm të dëmtuarit dëm materjal në vlerën e lartëcekur.*

*-me qka kishte për të kryer veprën penale , vjedhje e rëndë, nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së.*

*Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të bugjetit të Kshillit Gjyqsor të Kosovës.*

### **Arsyetim**

*Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur 11 aktakuzat e lartcekura ndaj të pandehurve për shkak të 17 veprave penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nenpar 1/31 te KPRK-se, nje nga neni 253 par. 1 nenpar.1.1 te KPK-se e nje vepre e vjedhjes nga neni 252 par.l te KPK-se e tri nga to ne bashkveprim paragrafi 2 të KPRK-se si dhe H. A.i nga B., per shkak ted y veprave penale blerja,pranimi ose mshefja e sendeve te perfituara me veper penale, nga neni 345 par.1 e 2 te KPRK-se.*

*Pasi qe I pandehuri I dyte Sh. R per momentin eshte I pakapshem-jeton diku ne perendim,ndersa I pandehuri I trete H. uk I pranoi veprat penale, duke pohuar se ato nuk I ka kryer, e ne mungese te deshmitareve dhe te demtuarve,dhe ne pajtim me prokurorin e shtetit, ndaj tyre u vequa procedura penale, dhe u procedua vetem per te akuzuarin e pare S.R,ndersa per te akuzuarin Sh. R do te leshohet leterrrreshtim.Ndersa per hire te ekonomizimit dhe efikasitetit si dhe per hire te te pandehurit, ai I bashkoi te gjitha lendet e arritura gjer me tani ne emer te te akuzuarit Sabit Rashiti-pra 11 sosh.*

*Në fillim të shqyrtimit kryesor gjyqesor, ted t.17.12.2015, pas leximit të aktakuzave, i pandehuri S. R, ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi aktakuzat dhe veprat penale për të cilat akuzohet, duke theksuar e pranojë fajësinë për kryerjen e 17 veprave penale te cila më vihet në barrë sipas këtyre aktakuzave, ne perjashtim te vepres penale nen dispozitivin e XVIII-te,te cilen nuk e kam kryer, se poqese do ta kasha kryer, sigurisht se do ta kasha pranuar edhe ate.*

*Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit edhe të prokurorit, avokatit te te akuzuarit sipas autorizimit.....,konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.*

*Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :*

*Se i pandehuri S.R, me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka kryer veprën penale vjedhje, nga nenet 327 par.1.1 lidhur me nenin 31 te KPRK. si dhe nenet 253/1-1 e e 252/1.2 te KPK, në kohën, vendin dhe mënyrat e përshkruara në 17 dispozitivat e këtij aktgjykimi.*

*Gjykata, e shpalli fajtor të pandehurin S. R, për shkak të veprave penale vjedhje-e rende,nga nenet e lartcekure, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njejtat është edhe përgjegjës penalisht.Ndersa, ne mungese te deshmime, ate e liroi nga pergjegjesia penale pre vepren nen dispozitivin e XVIII-te,nga se I njejti ishte shume I singerte dhe ia fali besimin se te njejten sigurisht se nuk e kishte kryer, si dhe askush nuk erdhi qe ate*

*edhe tia deshmoj,edhe perkunder se ishin ftuar te gjithe deshmitaret dhe te demtuarit per ne shqyrtimin gjyqesor,por mungesen asnjeri prej tyre edhe nuk e aresyetoj.*

*Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit S. R, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 64 të KPK, si dhe 73 të KPRK-se,ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë; sjelljen shumë të mirë të tij gjatë shqyrtimit kryesor; se ka shprehur keqardhjen për kryerjen e këtyre veprave penale; se i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduse ka marrë pasi që i njëjti është edhe recidivist i veprave të këtyra penale.*

*Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me burgim dhe me gjobe ndaj të pandehurit S. R. është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 34 të KPK-se dhe 41 të KPRK-se.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është bazuar në nenin 451 dhe 454 të KPPRK-së.*

*Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në bazë të nenit 463 të KPPRK-së.*

*Duke u bazuar nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitivat e këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr.951/13 të datës:18.12.2015**

**Sekretare juridike**  
**Florentina Ademi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Ramiz Azizi**

**KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.**



